

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan

Nisma “Për një Drejtësi Pa Vonesa”

PLANI I MASAVE

Hartuar në Takimin e Punës të datave 22-23 qershor 2017

Masat që do merren nga vetë Gjykata

Të punohet me pritishtërinë e palëve, më mënyrë që palët të ndërgjegjësohen se me ardhjen në gjykatë duhet të vinë të përgatitura dhe t’i disponojnë të gjitha provat.

Momenti i dorëzimit të kërkesëpadisë:

Kryesekretarja, do të kërkojë nga pala paditëse që të plotësohet formulari me të dhënat e kontaktit të paditësit, të të paditurit, adresat e plota, numrin e telefonit, të dhëna lidhur me çdo person tjetër apo numër tjetër kontakti, që mundëson njoftimin e palës si dhe të plotësojë formularin model për “dhënie e pëlqimin për njoftimin edhe nëpërmjet postës elektronike” (kur ekziston kjo mundësi). Kërkesë-padia nuk do pranohet pa këtë formular.

Gjykata do të ndërgjegjësojë palët dhe qytetarët për përdorimin e formularit nëpërmjet këndit të saj të informimit. Kryesekretarja do të sigurojë që kërkesë-padia, të përmbajë nga pikëpamja formale të gjithë elementët e saj, sipas nenit 153, 154 e vijues të K.Pr.Civile.

Për rrjedhojë, pala paditëse duhet të paraqesë provat në formën e kërkuar nga ligji dhe në numër kopjesh sa janë palët; të përcaktojë që në momentin e depozitimit të padisë, vlerën e padisë, dhe në bazë të saj sipas rastit të kryejë pagesën e taksës së regjistrimit të padisë (për ata që përjashtohen nga taksa, të bashkëngjitet kërkesa për përjashtim dhe aktet provuese që mbështet këtë kërkesë). Regjistrimi i padisë do të kryhet vetëm, pasi paraqitet kopja e mjetit të identifikimit të paditësit/ paditësve, në mënyrë që të shmangët dhënia e gjeneraliteteve jo të sakta.

Seanca Përgatitore:

Në seancat përgatitore nga ana e gjyqtarit apo trupi gjykues, sipas rastit të identifikohet nevoja për ekspert dhe kur është e nevojshme t’u vihet në dispozicion palëve lista e ekspertëve.

Në seancë përgatitore pyeten palët për provat të cilat nuk kanë arritur t’i disponojnë nga institucionet shtetërore, me qëllim që të identifikohet nevoja për kërkimin e akteve dhe dokumentacionit nga institucionet përkatëse si p.sh. ZRPP, ATP, etj.

Përgatitja e çështjeve duke planifikuar më mirë seancat e nevojshme për secilën çështje.

Në çështjet civile, kalimi në seancë gjyqësore, pas mbarimit të veprimeve përgatitore, në të njëjtën ditë, natyrisht në ato raste, kur nuk nevojitet të merren prova të tjera përveç atyre të dërguara nga palët dhe një gjë e tillë është e mundur.

Qëndrimi i unifikuar ndaj kërkesave për shtyrje, për të mos i dhënë shkak palëve për të paraqitur kërkesa për shtyrje te pabazuara në prova.

Masat që kërkohet të merren nga institucionet vendore dhe palët në gjykim

Gjykata do të organizojë takime me përfaqësues të nivelit të lartë të institucioneve vendore.

Takim i veçantë i organizuar nga Gjykata në bashkëpunim me organizatat partnere, me përfaqësues të institucioneve nga Komisariati i Policisë, Shërbimi Postar, etj.

Takim i veçantë me titullarin e ZRRP-së Elbasan dhe njëkohësisht vijimi i shkresave drejtuar institucionit për çështje konkrete.

Zyra Postare

Të udhëzohen dhe trajnohen herë pas here punonjësit/postierët e postës në bashkëpunim me titullarin e institucionit, për rregullat procedurale të njoftimit, me qëllim që të realizohet njoftimi i palëve sipas kërkesave të K.Pr.Civile dhe K.Pr.Penale *{psh. në rastet kur pala refuzon marrjen e njoftimit, të sigurohet ekzistenca e një dëshmitari, në rastin kur shkohet në banesë e pala nuk gjendet akti t'u njoftohet të afërmeve (familjarëve, apo fqinjëve)}*.

Për këtë qëllim do të zhvillohen edhe takime të veçanta me titullarin e Seksionit Postar, por edhe evidentimi i problematikave me shkrim, përfshirë edhe orientimin për kthimin e akteve që i bashkëngjiten njoftimit të kërkesëpadisë.

Gjykata do të paraqesë bashkëngjitur me fletë-thirrjen dhe provat e palës paditëse edhe “formularin e kontaktit për palën e paditur” ose “palën e tretë”, e cila duhet të kthehet e plotësuar në gjykatë nga nëpunësi postar, bashkë me fletë-thirrjen e nënshkruar.

Avokatia:

Takime ndërgjegjësuese me Dhomën Vendore të Avokatisë dhe informim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë për mospranimin e kërkesave për shtyrje për shkak të pjesëmarrjes në një gjykim tjetër, për listën e avokatëve kryesisht (përfshirë edhe marrjen e masave për heqjen e avokatëve nga lista).

Të informohen avokatët se në momentin e depozitimit, duhet që kërkesëpadia të plotësojë të gjitha elementët e kërkuara nga K.Pr.Civile, përfshirë edhe provat të siguruara nga institucionet përkatëse.

Formulari i të dhënave të kontaktit të plotësohet edhe nga avokatët. Gjykata i vendos në dispozicion kopjen me udhëzimet përkatëse për plotësim.

Nuk do të pranohen kërkesat për shtyrje për një gjykim tjetër.

Do të aplikohet kalendari i gjykimeve.

Anullimi i seancës dhe njoftimi i palëve paraprakisht kur ka dijeni për shkakun e moszhvillimit të saj.

Duhet të sigurojnë paraqitjen e provave që në seancën e parë, duke ia bërë me dije dhe palës tjetër, përpara seancës.

Në gjykimin e zakonshëm, të drejtpërdrejtë, dhe të shkurtuar, avokatët të jenë të përgatitur të paraqesin konkluzionet përfundimtare në një seancë me Prokurorin.

Prokuroria:

Të ndahet me Drejtuesin e Prokurorisë së rrethit problematika e mosparaqitjes së prokurorëve në seancë.

Të bihet dakord mbi një kalendar të ditëve javore të seancave gjyqësore.

Në çështjet penale, palëve u kërkohet të paraqesin në të njëjtën seancë pretendimet përfundimtare, aty ku është e mundur, sidomos në gjykimet e posaçme. Edhe kur procedohet me gjykim të shkurtuar, **prokurorit** dhe avokatit, do t'u kërkohet të paraqesin pretendimet përfundimtare brenda të njëjtës seancë, pa kërkuar shtyrjen e gjyimit për këtë shkak, pasi në rastin konkret, kërkesa për gjykim, e paraqitur nga prokurori dhe e pranuar nga gjykata si e tillë, do ishte e njëjtë edhe me diskutimet përfundimtare të çështjes në gjykim.

Komisariati i Policisë:

Takime me titullarin ku diskutohen problematikat e lidhura kryesisht me njoftimet (psh. marrja e konfirmimit të njoftimit të kryer para seance, kërkesat për marrjen e informacionit nga TIMS).

Përdorimi i komisarariatit për njoftimet paralele.

IEVP Peqin, Lushnje, Paraburgimi Elbasan:

Takime me titullarin ku diskutohen problematikat.

Ekspertët:

Kur është e mundur, thirrja e ekspertit në seancë përgatitore.

Dorëzimi i aktit të ekspertimit në gjykatë para seancës gjyqësore përkatëse me qëllim që palët të kenë mundësi ta konsultojnë aktin paraprakisht.

Gjykata e Apelit Durrës:

Takimi i veçantë me Gjykatën e Apelit Durrës me ndihmën e dy organizatave për diskutimin e problematikave.

Objektivat e Gjykatës

Me zbatimin nga secili aktor të masave të mësipërme në kuadër të Nismës Për një Drejtësi pa Vonesa, kërkohen të arrihen këto objektiva:

Për çështjet civile:

Të reduktohet mesatarja e numrit të seancave nga 3,7 në 3,5.

Për çështjet penale:

Të reduktohet mesatarja e numrit të seancave nga 3,1 në 3.

Seancat joproductive:

- Ulja e volumit të seancave joproductive në çështjet penale nga 35% në 20%.
- Ulja e volumit të seancave joproductive në çështjet civile nga 29% në 20%.

KRYETARI I GJYKATËS

SULEJMAN KURTI

Masa të tjera përtej Nismës

- Ngarkesa e lartë e [është] për shkak të numrit mjaft të ulët të gjyqtarëve, problematikës kjo që duhet ngritur edhe një herë me KLD
-